

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 107/2016, “PËR PREFEKTIN E QARKUT”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKT AKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”, të ndryshuar, ka si qëllim forcimin e rolit të prefektit të qarkut, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në territor, përfshirjen e tij aktive në koordinimin dhe ndërlidhjen e veprimtarisë së organeve qendrore në kuadër të ushtrimit të detyrave dhe kompetencave të tyre në nivel vendor. Prefekti i qarkut merr një rol gjithëpërfshirës edhe për bashkërendimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi problematikat në lidhje me emergjencat civile.

Me ndryshimet e propozuara, forcohet roli i Prefektit të Qarkut edhe në Këshillat Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillin Kombëtar të Sigurisë në Komunitet, përmes bashkërendimit dhe koordinimit me përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes, si dhe institucioneve në nivel qendror.

Projektligji ka si objektiv përmirësimin e bashkëpunimit midis Prefektit të qarkut, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, me qëllim rritjen e sigurisë publike dhe qetësisë në komunitet.

Për përmbushjen e qëllimit dhe objektivave del e nevojshme krijimi i një strukture të re, konkretisht “Prefekti Detar”, për forcimin e qeverisjes, sigurisë dhe koordinimit në zonat bregdetare. Rritja e zhvillimeve turistike, aktiviteteve detare, rreziqet mjedisore bëjnë të domosdoshme ngritjen e një strukture të specializuar që garanton zbatimin e politikave shtetërore në nivel vendor për zonat bregdetare.

II. VLERËSIMI I PROJEKT AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është parashikuar në Programin Analitik të Projektakteve për Ministrinë e Punëve të Brendshme, për vitin 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT AKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Gjatë zbatimit të ligjit aktual “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar, janë evidentuar problematika që lidhen me, koordinimin ndërmjet institucioneve qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore; qartësinë dhe ndarjen e kompetencave ndërinstytucionale; mungesën e rregullimit të detajuar për koordinimin në zonat bregdetare; nevojën për forcimin e rolit të Policisë Bashkiake në bashkëpunim me prefektin; përmirësimin e mekanizmave të raportimit dhe monitorimit në territor. Problematikat e konstatuara dhe nevoja e krijimit të Prefektit Detar, adresohen me përmirësime të ligjit aktual “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar.

Efektet e pritshme janë :

- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore për çështje të sigurisë dhe administrimit territorial.
- Forcimi i rolit të prefektit në koordinimin me Policinë e Shtetit dhe Policinë Bashkiake.
- Marrja e një roli edhe më gjithëpërfshirës për bashkërendimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi problematikat lidhur me emergjencat civile.
- Rritja e koordinimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore në nivel qarku dhe në zonat bregdetare.
- Raportim më i strukturuar pranë Këshillit të Ministrave mbi zbatimin e politikave shtetërore, veçanërisht atyre të planifikimit të territorit, menaxhimit të bregdetit dhe sigurisë së plazheve.
- Rritje e efektivitetit në menaxhimin e emergjencave civile.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe është në harmoni me legjislacionin vendas dhe nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT AKTIT

Projektligji i propozuar përbëhet nga 7 nene, me përmbajtje si vijonë:

- Neni 1 i projektligjit, ndryshon shkronjën “b”, të nenit 8, me këtë përmbajtje:
“b) koordinimin mbështetës në nivel qarku të veprimtarisë së institucioneve qendrore, sipas kompetencave dhe fushës së përgjegjësisë së tyre, në ndihmë dhe asistencë të kërkesave dhe nevojave të njësive të vetëqeverisjes vendore”. Ndryshimi qartëson rolin koordinues të prefektit me institucionet qendrore me njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- Neni 2 i projektligjit, ndryshon nenin 12, në titull dhe pikën 3, si dhe shton pikat 1/1 dhe 3/1, ndërhyrje në harmoni me projektligjin “Për Policinë Bashkiake”, dy ligje që synohen të hyjnë në fuqi në të njëjtën kohë. Sipas pikës 1/1, prefekti i qarkut koordinohet dhe konsultohet me Policinë Bashkiake dhe kryetarin e Bashkisë, mbi çështjet e sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, ndërsa sipas pikës 3/3, koordinon veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake, Policisë së Shtetit me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë forcohet bashkëpunimi i Prefektit me Policinë e Shtetit dhe Policinë Bashkiake por dhe shtohen detyrime për koordinimin me kryetarët e bashkive për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.
- Neni 3 i projektligjit, ndryshon nenin 12/1 të ligjit, duke shtuar pikën 1/1 dhe 1/2 dhe 2/1 me këtë përmbajtje:
“1/1 Prefekti i qarkut merr pjesë dhe mund të thërras mbledhjet e Këshillave Vendor të Sigurisë Publike (KVSP-ve), për shqyrtimin e çështjeve dhe problematikave për sigurinë publike në komunitet, përmes bashkërendimit dhe koordinimit me përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore si dhe institucionet në nivel qendror.
1/2. Prefekti i qarkut, përgatit rezultatet e nxjerra nga mbledhjet e Këshillave Vendor të Sigurisë Publike (KVSP-ve) dhe angazhohet të koordinojë veprimtarinë për adresimin dhe zgjidhjen e tyre, në koordinim me institucionet përgjegjëse qendrore.”
“2/1. Prefekti i qarkut merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet (KKSK-së) dhe është përgjegjës për prezantimin e problematikave për sigurinë publike në komunitet, në nivel qarku. Në këtë rast, prefekti i qarkut angazhohet të koordinohet me anëtarët e tjerë të Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet (KKSK-së) për adresimin dhe zgjidhjen e tyre.”

Me ndërhyrjet në nenin 12, prefekti merr rol aktiv dhe mund të thërras mbledhjet e KVSP-së, koordinon adresimin e problematikave të evidentuara gjatë mbledhjeve. Prefekti angazhohet të koordinohet me anëtarët e KKSK.

- Neni 4 i projektligjit, shton pikën 4, në nenin 13 të ligjit aktual me këtë përmbajtje:
“4. Prefekti i qarkut, bashkërendon me njësitë e vetëqeverisjes vendore lidhur me problematikat për mbrojtjen civile dhe koordinohet me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Forcat e Armatosura për adresimin dhe zgjidhjen e tyre.”
- Neni 5 i projektligjit, shton nenin 14/1 në ligjin aktual, duke sjellë si risi, përgjegjësinë e prefektit të qarkut për të koordinuar dhe ndërlidhur veprimtarinë e organeve qendrore, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tyre në nivel vendor. Gjithashtu, prefekti i qarkut bashkërendon veprimtarinë e organeve qendrore dhe organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore në raportet me njëra-tjetrën në nivel qarku. Neni 14/1, ka përmbajtjen si vijon :
“1. Prefekti i qarkut është përgjegjës të koordinojë dhe ndërlidhë veprimtarinë e organeve qendrore, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tyre në nivel vendor.
2. Prefekti i qarkut konsultohet dhe bashkëpunon me organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për çështjet dhe problematikat në nivel vendor.
3. Prefekti i qarkut bashkërendon veprimtarinë e organeve qendrore dhe organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore në raportet me njëra-tjetrën, në nivel qarku.
4. Prefekti i qarkut, njofton Kryeministrin në rastet kur nga ana e organeve qendrore ose ministrive nuk zgjidhen çështjet dhe problematikat e adresuara nga ana e Prefektit, në zbatim të këtij neni.”
- Neni 6 i projektligjit, shton nenin 22/1 dhe 22/2, krijohet struktura e “Prefektit Detar”, me juridksion mbi dhe nën lumin Seman, me qendër në Durrës dhe Vlorë. Dispozitat e shtuara përcaktojnë detyrat: koordinimi i sigurisë detare, menaxhimi i burimeve detare, siguria e plazheve, monitorimi i vijës bregdetare, lufta kundër aktiviteteve të paligjshme, emergjencat civile detare etj.
Neni 21/1 ka përmbajtjen si vijon :
“1. Prefekti detar është përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave, përgjegjës për çështjet detare në njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat në territorin e tyre kanë të përfshirë bregdet.
2. Prefekti detar emërohet dhe lirohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.
3. Parashikimet e neneve 6 dhe 7 të këtij ligji, zbatohen edhe për prefektin detar.
4. Këshilli i Ministrave emëron dy Prefekt detar, të cilët ushtrojnë detyrën e tyre brenda juridiksionit të prefekturës detare.

5. Qendrat e prefekturës detare janë në Durrës, për prefekturën mbi lumin Seman, dhe në Vlorë, për prefekturën nën lumin Seman.”

6. Struktura dhe organika e administratës së prefektit detar miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

- Në nenin 22/2 të shtuar përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të prefektit Detar, konkretisht:

“22/2. Në ushtrim të funksionit të tij, prefekti i qarkut ka këto përgjegjësi kryesore:

a) koordinimin mbështetës në nivel qarku të veprimtarisë së institucioneve qendrore, sipas kompetencave dhe fushës së përgjegjësisë së tyre, në ndihmë dhe asistencë të kërkesave dhe nevojave të njësive të vetëqeverisjes vendore në lidhje me sigurinë detare, luftimin e aktiviteteve të paligjshme në det, mbrojtjen e mjedisit detar, menaxhimin e burimeve detare, transportit detar si dhe monitorimin e vijës bregdetare.

b) raportimin periodik në Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e organeve qendrore në lidhje me veprimtarinë e tyre në qark për menaxhimin e integruar të zonave bregdetare dhe zbatimin e instrumenteve të planifikimit të territorit.

c) koordinon në nivel qarku me institucionet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore monitorimin dhe vlerësimin e vijës bregdetare si dhe zbatimin e kushteve dhe të sigurisë së plazheve;

ç) forcimin e kapaciteteve institucionale në zbatim të programeve të buxhetit të shtetit;

d) nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve e të veprimtarive me institucionet homologe sipas marrëveshjeve përkatëse;

dh) drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile detare;

e) drejtimin e task-forcave, krijimin e organizmave të përkohshëm, të komiteteve, të grupeve të punës dhe të komisioneve për çështje të caktuara detare;

ë) kontrollin dhe monitorimin e zbatimit, në nivel qarku, të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në fushën detare;

f) bashkërendimin e veprimtarisë së tij me agjencitë dhe inspektoratet përgjegjës për çështje detare që veprojnë në nivel qarku, si dhe monitorimin e veprimtarisë së tyre. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin me drejtuesit e këtyre institucioneve, prefekti i drejtohet ministrit përgjegjës;

g) ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të tjera që i ngarkohen me akte ligjore ose nënligjore.”

- Neni 7 i projektligjit përcakton hyrjen në fuqi, konkretisht 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen me zbatimin e projektligjit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura, prefektët e qarqeve, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Policia e Shtetit, Policia Bashkiake, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministrinë e Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamentin e Administratës Publike.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji ka efekte financiare në buxhetin e shtetit për ngritjen e administratës së Prefektit Detar me seli në Durrës dhe Vlorë, që përballohen brenda tavanëve buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Efekti financiar shtesë nuk mund të përllogaritet në këtë moment, pasi sipas parashikimit, struktura dhe organika e administratës së prefektit detar miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit. Ky proces ka nevojë për kohën e duhur, për përcaktimin e saktë të këtyre efekteve.

PROPOZUESI

MINISTRI

ALBANA KOÇIU